

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

“AUTORIPARIMI, SHITBLERJA, MBLEDHJA, DEPOZITIMI DHE SHKATRRIMI I MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE” Kodi VII.3.B.1/a,b,d,dh.

Zbatimi I detyrimeve Ligjore

1. Sektori i riparimit dhe i mirbajtjes së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, shitblerjes si dhe mbledhjen, depozitimin dhe shkatërrimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, drejtohet dhe mbykqyret nga Drejtuesi Teknik, i cili është i paisur me ‘Dëshmi e Aftësisë Profesionale të Drejtuesit Teknik’ nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugorë për këtë veprimtari, kodi VII.3.B.1
2. Drejtuesi Teknik dhe gjithë stafi teknik që punon në këtë sektor duhet të njohin dhe të zbatojnë me përpikmëri të gjitha detyrimet e:
 - Ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.
 - Udhëzimit nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës.
 - Rregullorës së sigurimit teknik në punë.
 - Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.
3. Sipas dispozitave të Ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, për drejtuesin teknik dhe të gjithë personelin teknik të këtij sektori riparimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:
 - “Autoriparim” është riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve me motor dhe e rimorkiove, të dëdënuara për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, me përjashtim të shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrave të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe lëngjeve ftohse.
 - “Veprimtari të riparimit” janë të gjitha operacionet për zëvendësimin dhe modifikimin e çdo komponenti të mjeteve me motor dhe rimorkiove, si dhe instalimin e impjanteve e të komponentëve fikse në një mjet të vetëm ose në një kompleks mjeteve me motor.

- “Veprimtari e mirmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove” është mirmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të karocerisë, të impjantit elektrik dhe të gomave.
 - “Veprimtari e shkatrrimit depozitimit të mjeteve me motor dhe rimorkiove” është vlersimi i pjesëve përberëse të mjeteve me motor dhe menaxhimi i tyre sipas ligjeve në fuqi për përdorim në riparimin e mjeteve të tjera aposhe shitjen e tyre.
4. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori për trajtimin e mjeteve rrugore me motor, duhet të respektojë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmeve.
5. Drejtuesit teknik dhe të gjithë personelit teknik të këtij sektori për trajtimin e mjeteve rrugore me motor, nuk i lejohe të kryejnë autoriparime të tjera nga ato të përcaktuara në regjistër, për të cilat është paisur me licencë shoqëria ‘**AUTOSERVIS BASHA**’shpk me Nipt **M07508201J, në Kukës.**
6. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori për trajtimin e mjeteve rrugore me motor, duhet të kujdeset dhe të dhe të mirmbajë të gjithë paisjet, instrumentat, mjedisin e nevojshme, të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit në riparim, demontim e mirmbajtjen e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.
7. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori për trajtimin e mjeteve rrugore me motor, do të ushtrojnë veprimtarinë e autoriparimit në përputhje me ligjin nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktitura dhe veprimtaritë që lidhen me to”. Mbjajnë përgjegjësi për operacionet e kryera sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (Kontrata e porosisë, kontrata e shitblerjes dhe ajo e qirasë).
8. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori, duhet të mbajë dhe të plotësojë regjistrin e riparimeve (operacioneve), ku të shënojnë në mënyrë të saktë e kronologjike, pa korigjime:
- Targën dhe numrin e shasisë së mjetit ku do të bëhen nderhyrjet.
 - Të dhënat për ndërhyrjet e realizuara.
 - Datën e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit pronarit të ligjshëm ose pësonit të autorizuar prej tij.
 - Gjeneralitetet e pësonit që dorzon mjetin dhe të pësonit të cilit i dorzohet mjeti.
 - Mbjajtja e të dhënave të përcaktuara më lartë, bëhet në çastin e marrjes dhe të dorzimit të mjetit.

- Të gjitha veprimet, për të cilat, sipas këtij ligji, kërkohet identifikimi i personit, është e nevojshme paraqitja e letërnjoftimit ose e një dokumenti tjetër identifikues, me fotografi, të leshuar nga organet përkatëse shtetërore.
- Në të gjitha rastet të dhënat për gjeneralitetet e personave, shënohet në regjister, së bashku me numërin e letërnjoftimit ose të dokumentit tjetër identifikues.

9. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori për trajtimin e mjeteve rrugore me motor, që mbajnë dhe plotësojnë regjistrin e punimeve, duhet t'ja vënë në dispozicion autoriteteve të caktuara për kontroll, si dhe autoriteteve të tjera që për motive të ndryshme, duhet të kontrollojnë shënimet e bëra në regjistra, pasi të ken njoftuar administratorin e subjektit.

10. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori për trajtimin e mjeteve rrugore me motor, duhet të njoftojn menjëherë administratorin e subjektit në rastet kur paraqitën për kontroll dhe zbatim të këtij ligji, punonjësit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR-së) dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët mund të kontrollojnë, në çdo rast, lejet dhe regjistrat e subjekteve, që ushtrojnë veprimtari të tillë sipas këtij ligji.

PËRSHKRIMI I INSTALIMIT/IMPIANTIT

“AUTOSERVIS”, INDUSTRIE PRODHUESE TE MAKINAVE DHE PAISJEVE

RIPARIMI I PAISJEVE MOTORIKE DHE MOTORCIKLETAVE NQS NUK JANE PERMENDUR DIKU TJETER NE KETE SHTOJCE.

KY INSTALIM "AUTO-SERVIS" USHTRON AKTIVITEIN E TIJ NE KUSHTE OPTIMALE ME TEKNOLOGJIN E KOHES.

PROGRAMI I PUNES TONE KONSISTON NE RIPARIMIN E AUTOVETURAVE NE SISTEMIN ELEKTRIK, NE SISTEMIN XHENERIK, SI DHE NE ATE TE PERGJITHSHEM.

TRAJTIMI I MBETJEVE VAJORE DO TE KRYHET NE BAZE TE LEGJILACIONIT NE FUQI DUKE E TRAJTUAR (DORZUAR) PRANE FIMAVE TE LICENCUARA PER KETE SHERBIM.

AMBJENTET E PUNES JANE BRENDA TE NJEJTIT OBJEKTIT ME PARAMETRA TE DUHURA PER USHTRIMIN E AKTIVITETIT, QE NDODHET NE Kukës; KUKES; Shtiqën; Lagjja 'Rexhepaj'; Rruga e Vjeter Kukës-Uzin km 3; Zona Kadastrale Nr. 3425; Nr. Pasurie 25

PERSONI FIZIK " FLAMUR BASHA " AMBJENTET E PUNES I KA NE GODINE ME SIP NDRITIMI TOTALE 529.3 m². NE KATIN PERDHE E NDARE NE REPARTE TE VECANTA SIPAS SPECIFIKAVE E SPECIALITETEVE PERKATESE. PJESA TJETER E PRONES PERDORET PER PARKINGUN E MAKINAVE.

Autoservis BASHA shpk
NIPT: M07508201J

Adresa: Lagjja Rexhepaj, Rruga 'Kukës-Uzinë'
Km 3, Zona Kadastrale Nr.3425, Nr.Pasurisë 25,
Shtiqën, Kukës.

THEKSOJM SE NJE SPERFAQE PREJ 350 M2 ESHTË E SHTRUAR ME PLLAKA BETONI.

NE KETE SUBJEKT PUNOJNE GJITHESEJ 3 PUNONJES TE CILET JANE TE SPECIALIZUAR NE FUSHAT PERKATESE TE KETIJ AKTIVITETI KU KARAKTERISTIKE ESHTË ELEKTROUTI, MOTORRISTI E XHENERIKU etj..

ZHURMAT JANE NORMALE PER ZONE KU ESHTË INSTALUAR AKTIVITETI DHE ATO PAK ZHURMA JANE GJATE ORARIT TE PUNES TE PA PERFILLSHME.

FURNIZIMI ME UJE DHE ENERXHI ESHTË I PLOTE DHE ME KONTRATA TE RREGULLTA ME UK-KUKES DHE OSHEE - KUKES.

TEKNOLOGJIA E INSTALUAR PER VEPRIMTARIN E MESIPERME ESHTË NE PARAMETRA OPTIMALE DHE NUK LE ASNJE LLOJ MBETJE.

MBETJET URBANE QE GJENEROHEN TRAJTOHEN NE VENDGRUMBULLIMIN E PERCAKTUAR NGA PUSHTETI VENDOR.

MBETJET NGA RIPARIMET TRAJTOHEN BRENDA VENDIT TE INSTALIMIT DHE NE PERIUDHA TE HEREPASHERSHME I DORZOJM NE PIKAT E GRUMBULLIMIT TE HEKURISHTEVE PASI JANE TE TILLA.

VLSERSOJM TE THEKSOJM SE PER RRETH INSTALIMIT NUK KA SHTEPIA BANIMI DHE VETE INSTALIMI ESHTË I RRETHUAR ME MURE DHE BIME TE LARTA.

Rregullore brëndshme e veprimtarisë

"Autoriparimi, shitblerja, mbledhja, shkatërrimi dhe depozitimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove" kodi vii.3.b.1/a.b.d.dh

PLAN RILEVIMI

<p>HARTOI: Top. Skender Laçi</p> <p>Nr.Licenses T 0392/1 Firma: <i>SKENDER LAÇI</i></p> <p><i>SHKURTYRI</i></p> <p>Shënim: Ky plan rievimi u hartua për të paraqitur sheshin i cili do të përdoret për mjeteve që do të shkatërrohen dhe pjesët e ndërrimit të automjeteve të dalja jashtë përdorimit. Ky shesh prek në pasurisë 1383 dhe 1564 të z.k. 3425 të cilat faktikisht posedohen nga porosites.</p> <p>DATA E PERGATITJES 18.11.2020</p>	<p>IDENTIFIKIMI I PASURISE</p> <p>ZONA KADASTRALE: 3425 NR.PASURISE 1383, 1564 INDEKSI I HARTES K-34-65-(207-C) SHKALLA 1:1000 ADRESA E PASURISE BASHKIA KUKES NJESIA ADMINISTRATIVE SHTIQEN FSHATI KODER LUME SIPERFAQJA E PRONES 600 m² EMERTIMI POPULLOR MALI BEQES</p>
<p>KUFIZIMET E PRONES</p> <p>VERI: Pas.1383 LINDJE: Pas. 1564 JUG: Pas.1383 PERENDIM: Pas. 1382</p>	<p>POROSITES : • JASIM MEDI BASHA "AUTOSERVIS BASHA "</p>



Rregullore brendshme e veprimtarisë

"Autoriparimi, shitblerja, mbledhja, shkatërrimi dhe depozitimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove" kodi vij.3.b.1/a.b.d.dh

Zbatimi i Rregullave të Sigurimit Teknik

1. Mbrojtja në punë përfshinë tërësinë e dispozitave, masave teknike, shëndetësore e shoqëore që kanë për qëllim sigurimin e kushteve sa më të përshatshme për të parandaluar aksientet në punë, sëmundjet profesionale dhe disa sëmundje të tjera të përgjithshme që lidhen me mjedisin e punës, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorëve.
2. Nocioni i mbrojtjes në punë në kuptimin e gjerë ka të bëjë me sistemin e masave dhe mjeteve për mbrojtjen e punëtorit, si aspektin e legjislacionit të punës, ashtu dhe në aspektin e aplikimit të masave teknike, organizative dhe masave tjera qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të punëtorëve.
3. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore kanë për detyrë të shfrytëzojnë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale për punët që kryejnë.
4. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, para fillimit të punës të kontrollojnë dhe verifikojnë gjendjen e pajisjeve dhe instrumentave të punës dhe veglave të mbrojtjes personale.
5. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, në rast të ndonjë difekti të pajisjeve dhe instrumentave të punës dhe veglave të mbrojtjes personale menjëherë duhet të informojnë administratorin e subjektit.
6. Në rastin e ndonjë lëndimi në punë, drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, të ndihmojnë në evitimin e pasojave.
7. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, janë të obliguar që punën e tyre ta kryejnë me kujdes të plotë dhe pa rrezik për jetën dhe shëndetin e tyre të punëtorëve të tjerë, si dhe pa rrezik për mjetet me të cilat drejtpërdrejti ose në mënyrë të tërthortë punojnë.
8. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, janë të obliguar që tu përmbahen të gjitha masave, normave dhe udhëzimeve të parapara për mbrojtjen në punë, që të kujdeset për zbatimin e mbrojtjes në punë dhe të kryejnë dhe vizitat mjekësore periodike, me qëllim kontrollin e gjendjes shëndetësore të tyre.

9. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, janë të obliguar që të shfrytësojnë të gjitha instrumentat dhe pajisjet e mbrojtjes personale në punë, për qëllimin e dedikuar dhe që ti përdorë ato me kujdes, që ti mbajë ato në gjendje të rregullt dhe që të mos i ndërrojë me punëtorë tjerë nëse janë për përdorime personale.
10. Nëse drejtuesi teknik ose ndonjë nga personeli teknik i këtij sektori riparimi, kanoset rreziku i drejtpërdrejt për jetën ose shëndetin, për shkak se nuk janë masat e mbrojtjes në punë, ata kanë të drejtë dhe duhet të refuzojë të punojë në atë vend pune, përderisa nuk zbatohen masata përkatëse të mbrojtjes.
11. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi, nëse ka të meta shëndetësore të cilat të meta fare nuk mund të konstaktohen në shikimin mjekësor, është i obliguar që ato të meta respektivisht sëmundje, të paraqesë para fillimit të punës administratorit të subjektit.
12. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, janë të obliguar që pa vonesë të lajmrojë administratorin e subjektit për çdo lëndim që i ndodh në punë.
13. I gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore është i obliguar ta nderpresë punën, nëse atë e kërkon drejtuesi teknik i tij për rastet kur:
 - a. Nuk i zbaton masat e nevojshme dhe të domosdoshme të mbrojtjes në punë
 - b. Nuk i shfrytëson pajisjet dhe mjetet e mbrojtjes personale
 - c. Nuk është i aftë për punë, sepse gjendet në gjendje të tillë psiko-fizike, për shkak të së cilës rrezikon vetën, punëtorët tjerë dhe mjetet e punës.
14. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjetesh rrugore, nuk u lejohej të fillojnë punën ose të punojnë nën ndikimi të alkoolit ose narkotikëve.

Zbatimi i Rregullave të mbrojtjes nga zjarri

1. Materialet ndezëse, eksploduese, të nxehta, helmuese dhe brejtëse, duhet të mbahen vetëm në enët e përshtatshme dhe vende të sigurta nën mbikqyrje dhe të mbyllura.
2. Gjatë punës me material ndezëse, eksploduese dhe lëngje të rrezikshme, rreptësisht ndalohej pirja e duhanit, përdorimi i zjarrit të hapur dhe i mjeteve të ndezura. Gjithashtu në këtë llojë

punësh, nuk duhet të përdoren veglat dhe pajisjet të cilat mund të prodhojnë shkëndija elektrike.

3. Riparimi i pjeseve të brëndshme të kazanave, cisternave, rezervarëve, kanaleve, etj., në të cilat mund të ketë gazra ndezëse dhe eksploduese, mund të bëhet vetëm me llampa elektrike të punuara me mbrojtëse sigurose dhe me tension të ulët.
4. Drejtuesi teknik dhe i gjithë personeli teknik i këtij sektori riparimi mjeteve rrugore, duhet të njohë dhe të përdorë fikësit e zjarrit, në raste të nevojës së përdorimit të tyre kur bie zjarr në repartin e riparimit.
5. Pajisjet elektrike, instalimet dhe aparatet, të cilat mund të shkaktojnë zjarr, duhet të jenë të vendosura sipas dispozitave të standarteve në fuqi, respektivisht të normave dhe dispozitave dhe përvojave të mirënjohura dhe miratuara teknike.
6. Te gjitha punët në instalimet dhe pajisjet elektrike, duhet të bëhen dhe kontrollohen në vazhdimësi nga persona të kualifikuar dhe posaçërisht të aftësuar, që janë të ngarkuar nga administratori për repartet, pajisjet, aparatet, etj.
7. Elektriciisti mban përgjegjësi të plotë, për kualitetin dhe rregullsinë e riparimeve elektrike në repartin e mirëmbajtjes dhe rimarimit të pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË OPERIMIT

Nje nga objektivat e ketij raporti(Shtojce) eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky projekt ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone per vet llojin e aktiviteti nuk vlersojme ndikime te konsiderushem me ndikim ne mjedis.

MASAT LEHTESUESE.

Do te behet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike.

Lyerja dhe rregullimi i fasades se jashteme duke krijuar nje pamje me te kendshme

Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta ku keto mbetje ku do te behet e mundur gjithmone lidhja e kontrates me subjekte te licensuara per menaxhimin e ketyre mbetjeve urbane te prodhuara, te cilat depozitohen ne kosha te percaktuar nga Bashkia Kukes, ku do te jete nje sasi prej 0.4-0.6 kg/dite mesatarisht per person.

Nr.	Mbetjet ne piken e instalimit	Cod. CER	Rekuperimi /asgjesim	Asgjesuesi	Klasifikimi i mbetjes
1	Mbetjeurbane, mbetje ambalazheve te ndryshme.		Konteniere te vecante	Njesia Vendore Bashkia Kukës	E pademshme

Detyrimet e punedhenesit: Punedhenesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e punes ne frontin ku punon.
2. Teknologjia qe perdoret dhe menyren e perdorimit.
3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
4. Ndhimen e pare shendetesore.
5. Gjithashtu duhet tu njohe rregulloren e mbrojtjes kundra zjarrit si dhe trajnimi ipunonjesve ne ketij objekti duke krijuar situata te simuluar.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar ngaInspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve gjate aktivitetit, per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, doreza, perparesen e bardhe etj.
5. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa

kritereve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Autoservis BASHA shpk
NIPT: M07508201J

*Adresa: Lagjja Rexhepaj, Rruga 'Kukës-Uzinë'
Km 3, Zona Kadastrale Nr.3425, Nr.Pasurisë 25,
Shtiqën, Kukës.*

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit "Për monitorimin e mjedisit në RSH", kreu III, pika 10.

. Investitori do të monitorojë vetëm pikat për të cilat ai ndikon mbi to (pikat do të përcaktohen nga organet kompetente.

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar.

Për "AUTOSERVIS BASHA"

ADMINISTRATORI

Jasim BASHA



Kukës më: 12.03.2021

Rregullore brendshme e veprimtarisë

"Autoriparimi, shitblerja, mbledhja, shkatërimi dhe depozitimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove" kod i vit.3.b.1/a,b,d,dh